

Shoqeria Romano Port ka përgatitur një rregullore në të cilën është parashikuar, Struktura Organizative, Organet Drejtuese si dhe Forcat e Sigurisë Portuale

Me anën e kësaj rregulloreje është organizuar dhe funksionon aktiviteti i **shërbimit, menaxhimit si dhe i sigurisë** në portin e shkarkimit të lendeve djegëse në Porto Romano, Durrës

FORCAT E SIGURISË PORTUALE TE ROMANO PORT

MISIONI I FORCES SE SIGURISË ANIJE - PORT

Forca e Sigurisë Anije –Port **ka për mision garantimin e sigurisë së Fasalitetit Port-Anije**. Ajo e realizon atë :

1. Nepermjet zbulimit e vleresimit ndaj kërcënimeve të sigurisë dhe, marrjen e masave paraprake kundrejt incidenteve që prekin sigurinë e Fasalitetit Portual apo të Anijes.
2. Nepermjet përcaktimit të detyrave konkrete dhe përgjegjësive funksionale të FSAP për të vendosur sigurinë.
3. Nepermjet sigurimit të një këmbimi të shpejtë dhe objektiv të **informacioneve** me Policinë e Shtetit; Ministrinë e Mbrojtjes; Kapitenerinë e Portit **ne lidhje me sigurinë detare**.
4. Nepermjet pasjes së një **metodologjije** të vleresimit të gjendjes së sigurisë, për të vepruar siç duhet në rastet e ndryshimit të nivelit të sigurisë.
5. Nepermjet përzgjedhjes dhe përgatitjes së personelit të cilet do t'i japin efektin e duhur Planit të Sigurisë së Fasalitetit Portual.

FORCAT E SIGURISË PORTUALE

1. FSAP parashikon dhe vendos forma inteligjence dhe investigimi
2. Nxiti ndërgjegjësimin e operatorëve në port, personelit port-anije-port, të përshtaten me kushtet dhe kërkësat e sigurisë
3. Krijon formacione, përgatit taktika dhe stërvitje periodike të përcaktuara në planet e sigurisë.

Forcat e sigurisë portuale veprojnë dhe mbështeten sipas ligjeve

- Ligji nr 9281 dt: 23/0/2004 “Për Sigurimin në Anije dhe Porte”.
- Ligji nr 9130 dt: 08/09/2003 “Për Autoritetin Portual”.
- Ligji nr 8756 dt: 26/03/2001 “Për Emergjencat Civile”.

- Ligji nr 8290 dt: 24/02/1998 “Per Perdorimin e Armeve te Zjarrit”.
- Ligji nr 9861 dt24/04/2001“Mbi Kontrollin dhe Mbikqyrjen e Kufirit Shteteror”
- Veprimtaria e Sherbimit te Forces se Sigurise Portuale do te mbeshtetet ne aktet ligjore te Policise se Shtetit, si per organizimin dhe rregullat e brendshme, ashtu edhe per kriteret e nderhyrjes per mbrojtjen dhe sigurine e Fasalitetit Portual.
- FSAP ka atributet e policise gjyqjesore.
- Ne egzistencen e nje bashkepunimi, bashkeveprimi e kordinimi te punes me Policine e Shtetit; Ministrine e Mbrojtjes; MNZ, Kapitenesise se Portit me objekt **Realizimin e misionit te FSAP.**

“Per Sigurimin ne Anije dhe ne Porte “

Forca e sigurise portuale ushtron aktivitetin e saj sipas dispozitave dhe ligjit Nr 9281 date 23.09.2004 “ per sigurine ne anije dhe ne Porte “ per te siguruar jeten, pronen, dhe shmangien e rrezikut ndaj veprave kriminale.

Neni I

Qellimi I ligjit

Qellimi I ketij ligji eshte garantimi I sigurise ne anije dhe ne porte, si dhe parandalimi I akteve terroriste ne permbushje te detyrimeve te vendosura nga aktet juridike, kombetare dhe nderkombetare.

Neni II

Objekti I ligjit

Objekt i ketij ligji eshte ngritja e nje force sigurie ne port, percaktimi I struktures se organizimit dhe rregullat, sipas se cilave do te veproje kjo force, ne bashkepunim me organet shetore dhe ato te perfaqesimit ne porte.

Hyrja e personave ne Portin “Romano Port” per nevoja pune, biznesi apo zyrtare do ti nenshtrohet zbatimit dhe respektimit te kerkesave te Kodit **ISPS** (Kodi I Sigurimit te Anijes dhe Sigurise Portuale) si dhe ligjit Nr 9281 per sigurine ne anije dhe ne porte si dhe rregullores se sherbimit te sigurise te fasilitetit portual FSAP

MASAT E SIGURISE

Masat e sigurise qe sherbimet e forces se FSAP marrin ne nivele sigurie te larta jane (Niveli i Sigurise Nr 1 , 2 dhe 3) jane masa sigurie qe do te zbatohen per mbrojtje ndaj ndonje rreziku te madh,ndaj nje incidenti sigurie duke siguruar nje vigjilence te madhe dhe kontroll te rrepte ne te gjithe fasilitetet mbrojtese te anijes cisterne dhe te Pontilit te hidrokarbureve.

Monitorohet hyrja /dalja ne Anije/Fasalitetin Portual te; punonjeseve, vizitoreve e marinareve duke kontrolluar rreptesisht dokumentacionin perkates dhe duke ushtruar kontroll fizik dhe sendeve personale.